


15
LUTJE
PËRMBLEDHËSE



HOXHË LULZIM PERÇUKU

Titulli i librit:
“15 lutje përmbledhëse”

Ligjëroi:
Hoxhë Lulzim Perçuku

Kontrolloi:
Hoxhë Lulzim Perçuku

Transkriptoi:
Albiona Olluri

Kopertina dhe faqosja:
Denisa Zeqiri

Prill, 2025

LUTJA E PARË

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْهُدَى، وَالتَّقَى، وَالْعَفَافَ، وَالْغِنَى

All-llahum-me in-ní eselu kel hude, wet-tuká, wel afêfe, wel giné.

**“O Allah! Kërkoj prej Teje udhëzim,
devotshmëri, dëlirësi dhe vetëmjaftueshmëri!”**

Shënon Muslimi.

—... *Sqarimi* ...—

***Udhëzimi dhe devotshmëria** përfshijnë çdo gjë prej së cilës është detyrë largimi, siç është: shirku, mëkati, sjelljet e ulëta etj.

*Dijetari imam Neveviu, (Allahu e mëshiroftë), duke komentuar këtë lutje, ka thënë: *“Me dëlirësi qëllimi është pastrimi shpirtëror dhe largimi prej gjërave të ndaluara. Kurse, me vetëmjaftueshmëri është pasuria shpirtërore (mospasja nevojë për pasurinë e cila është në duart e njerëzve).”*

*Es Sadi, (Allahu e mëshiroftë), ka thënë: *“Kjo lutje është prej lutjeve më përmbledhëse dhe më të dobishme. Ajo përfshin të mirat fetare dhe të mirat e kësaj jete. Kjo sepse udhëzimi është dija e dobishme, kurse devotshmëria është kryerja e veprave të mira dhe braktisja e ndalesave. Me plotësimin e tyre përmirësohet feja e njeriut. Pastaj, dëlirësia dhe vetëmjaftueshmëria përfshijnë pastrimin*

shpirtëror - moslidhjen e zemrës për krijesa, të mjaftuarit me furnizimin që ke dhe kënaqjen me atë që të është dhënë, si dhe të kesh mjaftueshëm aq sa të arrish qetësinë e zemrës dhe prehjen shpirtërore. Dhe me këtë plotësohet lumturia në jetën e kësaj bote dhe arrihet qetësia e zemrës.

Andaj, atë të cilin Allahu e furnizon me udhëzim, devotshmëri, dëlirësi dhe vetëmjaftueshmëri, ai arrin lumturinë në të dyja botët, realizimin e synimeve dhe shpëtimin prej gjërave të cilat nuk i dëshiron.”

LUTJA E DYTË

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْجَنَّةَ وَمَا قَرَّبَ إِلَيْهَا مِنْ قَوْلٍ أَوْ عَمَلٍ
وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ النَّارِ وَمَا قَرَّبَ إِلَيْهَا مِنْ قَوْلٍ أَوْ عَمَلٍ

All-llahum-me in-ní es'elukel xhen-nete we mé karrabe
ilejhé min kaulin ew amelin. We e'údhu bike minen-néri
we me karrabe ilejhé min kaulin ew amelin.

**“O Allah! Kërkoj prej Teje të më japësh Xhenetin dhe
(të ma mundësosh) çdo fjalë apo vepër që afron tek ai!
Kërkoj prej Teje të më mbrosh prej Xhehenemit dhe
prej çdo fjale apo vepre që afron tek ai!”**

Shënon Ibën Maxhe – Sahih.

—... *Sqarimi* ...—

* Ne duhet ta lusim Allahun të na mundësojë ta fitojmë Xhenetin dhe të na mundësojë të veprojmë shkaqet që dërgojnë tek ai. Xheneti është mirësia më e madhe, më e plotë dhe e përhershme.

* Ne duhet ta lusim Allahun gjithashtu të na ruajë prej zjarrit të Xhehenemit dhe prej shkaqeve të cilat e detyrojnë hyrjen në të. Xhehenemi është e keqja më e madhe dhe është i përhershëm.

* Është e rëndësishme që besimtari t'ua mësojë këtë lutje familjarëve të tij.

LUTJA E TRETË

اللَّهُمَّ أَصْلِحْ لِي دِينِي الَّذِي هُوَ عِصْمَةٌ أَمْرِي، وَأَصْلِحْ لِي دُنْيَايَ
الَّتِي فِيهَا مَعَاشِي، وَأَصْلِحْ لِي آخِرَتِي الَّتِي فِيهَا مَعَادِي، وَاجْعَلْ
الْحَيَاةَ زِيَادَةً لِي فِي كُلِّ خَيْرٍ، وَاجْعَلِ الْمَوْتَ رَاحَةً لِي مِنْ كُلِّ شَرٍّ

All-llahum-me eslih li dinnil-ledhi huwe ismetu emri. We
eslih li dunjéjel-letí fihé meâshí. We eslih li ékhiratíl-letí
fihé meâdí. Wexhâilil hajéte zijédeten lí fí kul-li khajrin
wexhâilil-meute ráhaten lí min kul-li sherrin.

**“O Allah! Përmirësoje fenë time e cila e mbron çështjen
time! Përmirësoje dunjanë time në të cilën jetoj!
Përmirësoje ahiretin tim ku unë do të kthehem! Bëje
jetën time shtesë në çdo të mirë! Bëje vdekjen time
rehati prej çdo të keqeje!”**

Shënon Muslimi.

—... *Sqarimi* ...—

✱ **“Përmirësoje fenë time e cila e mbron çështjen time!”**-
Fillon me përmirësimin e fesë, ngase kur përmirësohet ajo,
atëherë përmirësohet kjo jetë dhe jeta tjetër. Kuptimi i
përmirësimit të fesë: Kryerja e obligimeve fetare dhe zbatimi
i rregullave të fesë në mënyrën më të mirë. Kjo arrihet kur
Allahu të jep sukses dhe të inspiron t’i përmbahesh Kuranit
dhe sunetit sipas udhëzimit të gjeneratave të para
muslimanëve (selefit): në çështjet e besimit, në adhurime, në
thirrjen për tek Allahu, në morale etj.

***“Përmirësoje dunjanë time në të cilën jetoj!”** - Në kuptimin që Allahu të të japë furnizim të mjaftueshëm, për ato gjëra që ke nevojë, të jetë furnizim i lejuar (hallall) dhe të ndihmoresh me të për të bërë adhurime.

***“Përmirësoje ahiretin tim ku unë do të kthehem!”** - Ky përmirësim bëhet kur Allahu të përfshin me Mëshirën dhe butësinë e Tij, duke të dhënë sukses që të jesh i sigurtë në adhurime (të kesh ikhlas) dhe të pasosh sunetin në to, të ta mundësojë përfundimin e mirë (në jetën e kësaj bote) dhe të fitosh kënaqësinë e përhershme në Xhenet.

***“Bëje jetën time shtesë në çdo të mirë”** - prej fjalëve e veprave. Jeta e gjatë për muslimanin është shkak për shtimin e veprave të mira, devotshmërisë, adhurimeve etj.

***“Bëje vdekjen time rehati prej çdo të keqeje”** - kur të vdesësh të jesh i rehatuar prej fitneve, mëkateve, sprovave, shkujdesjes, etj. Besimtari do të arrijë rehatinë e plotë kur ta takojë Allahun dhe të fitojë kënaqësinë e përhershme në Xhenet.

LUTJA E KATËRT



رَبِّ هَبْ لِي مِنَ الصَّالِحِينَ

Rabbi heb lí mines-sálihín.

“O Zoti im, dhurómë një fëmijë prej të mirëve!”

Saffat 100.



—...*Sqarimi*...—

- * Një fëmijë i cili është i devotshëm, besimtar i mirë, që i bindet Allahut dhe që vendos rregull në tokë e nuk bën ngatërresa.
- * Fëmija i mirë është dhuratë e çmuar dhe mirësi madhështore (vetëm) prej Allahut. Andaj, njeriu e ka për obligim ta falënderojë shumë Allahun për të.
- * Duhet ta lusim Allahun të na dhurojë fëmijë të tillë të mirë. Kush ka fëmijë, duhet të lusë Allahun t'i ruajë ata dhe t'i bëjë të devotshëm.
- * Kur njeriu të vdesë i ndërpriten veprat përveç tri rasteve, prej tyre: fëmija i mirë e i devotshëm që lutet për të. Dhe sa herë që ai lutet, prindi do të ketë shpërblime.
- * Kjo është lutja që e ka bërë Ibrahim (alejhisselam). Dhe fëmija të cilin ia ka dhuruar Allahu ka qenë Ismaili (alejhisselam).

LUTJA E PESTË



رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا

Rabbi zidni ilmé

“O Zoti im, shtoma dijeninë!”

Ta he 114.



—...*Sqarimi*...—

* D.m.th. shtoma diturinë/dijeninë që ma ke dhënë. Pejgamberi (salAllahu alejhi ue selem) i ka kushtuar kujdes të madh kësaj lutjeje, gjithashtu edhe sahabët.

* Abdurrahman Sadi ka thënë: *“Allahu e ka urdhëruar Pejgamberin (salAllahu alejhi ue selem) ta lusë Atë t’ia shtojë diturinë sepse e gjithë ajo është mirësi. Shtimi i mirësisë është një gjë (synim) që kërkohet prej besimtarit. Dituria është dhuratë prej Allahut (ia jep kujt të dëshirojë). Rruga për të arritur te dituria është: dhënia mund në arritjen e saj, malli dhe dashuria për të, kërkimi i saj prej Allahut dhe kërkimi i suksesit prej Tij në këtë rrugë...”*

* Imam Maliku ka thënë: *“Është prej natyrës së birit të Ademit (njeriut) të mos ketë mundësi të dijë çdo gjë, gjithashtu është prej natyrës së tij të harrojë pas një kohe atë që di apo një pjesë të saj. Prandaj, duhet gjithherë të kërkohet prej Allahut t’ia shtojë diturinë.”*

LUTJA E GJASHTË

رَبَّنَا إِنَّا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةٌ وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةٌ وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ

Rab-bené étiné fíd-dunjé haseneten we fil ékhirati
haseneten we kiné ádhében-nár.

**“Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep
të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi
i Zjarrit (të Xhehenemit)!”**

Bekare 201.

—... *Sqarimi* ...—

* Përfshin të gjitha mirësitë e kësaj bote, si: shëndeti, furnizimi me bollëk, shtëpia komode, bashkëshorti/ja e devotshme, fëmijë që të kënaqin shpirtin, dituria e dobishme, veprat e mira, siguria, mirëqenia, përmendja për të mirë etj.

* Ndërsa, mirësitë e botës tjetër janë: më e madhja hyrja në Xhenet, siguria prej frikës kur njeriu pret Gjykimin e Allahut, lehtësimi i llogaridhënies, rëndimi i peshores me vepra të mira, marrja e librit të veprave të mira me dorën e djathtë, kalimi i Urës së Siratit me shpejtësi etj.

* **“na ruaj nga dënimi i Zjarrit”** - na ruaj të mos hyjmë në të, dhe kjo kërkon që Allahu të na lehtësojë shkaqet qysh në jetën e kësaj bote të cilat largojnë nga xhehenemi, si: largimi prej mëkateve, braktisja e ndalesave etj.

LUTJA E SHTATË

رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

Rabbené heb lené min ezwéxhiné we dhurr-rrij-jetiné
kurr-rrate e'âjunin wexh'âlné lil mut-tekiné imémé.

**“O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe
trashëgimtarët tanë, ç’është prehe për sytë
tanë dhe bëna shembull për të mirët!”**

Furkan 74.

—...*Sqarimi*...—

*Dhurona gra dhe pasardhës të atillë të cilët kur i shikojmë, atëherë sytë tanë kënaqen e shpirti gjen prehe, dhe të cilët të adhurojnë Ty o Allah e të binden.

*Prehe për sytë tanë në këtë botë dhe tjetrën.

*Dijetarët kanë thënë: “*Nuk ka gjë që e kënaq më shumë syrin e besimtarit dhe e qetëson shpirtin e tij, sesa kur sheh familjen e tij duke iu bindur Allahu dhe duke e pasur frikë Atë.*”

*Sadi (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “*Kjo lutje edhe pse është për bashkëshortet dhe pasardhësit, njëkohësisht është edhe për vetveten, kjo sepse dobia i kthehet personit (që lutet) dhe të gjithë muslimanëve ngase nëse përmirësohen familjarët (gruaja e fëmijët), atëherë do të përmirësohen edhe shumë njerëz të tjerë (me të cilët kanë lidhje).*”

***“bëna shembull për të mirët”** - bëna prijës të udhëzimit, që të tjerët të udhëzohen përmes nesh, e mos na bëj prijës të devijimit që të tjerët të devijojnë përmes nesh, bëna prijës në mirësi dhe thirrës që janë model/shembull për të tjerët (në vepra të mira, morale të larta etj.).

LUTJA E TETË

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَشْرِكَ بِكَ وَأَنَا أَعْلَمُ، وَأَسْتَغْفِرُكَ لِمَا لَا أَعْلَمُ.

All-llahum-me in-ní eûdhu bike en ushrike bike we ené
e'âlem, we estegfiruke limé lé e'âlem.

**“O Allah! Kërkoj mbrojtje tek Ti që të mos bëj shirk
në adhurim me vetëdije (duke e ditur) dhe kërkoj falje
tek Ti nëse bëj shirk pa vetëdije (duke mos e ditur)!”**

Shënon Buhariu.

—... *Sqarimi* ...—

* Këtu përmendet e keqja më e madhe - shirku, prej të cilës duhet të kërkojmë mbrojtje tek Allahu.

* Shirku është padrejtësia më e madhe. Allahu thotë:
“...mos i shoqëro Allahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe”. (Lukman 13)
Ai që bën shirk, vërtet ka bërë një mëkat shumë të madh dhe është shumë larg rrugës së drejtë.

* Ne duhet të tregohemi të kujdesshëm të mos biem në shirk, prandaj është e domosdoshme të njohim shirkun në mënyrë që të ruhem prej tij. Përveç kësaj, duhet të lutemi tek Allahu të na ruajë prej shirkut (me të gjitha llojet e tij), atë që e dimë dhe atë që nuk e dimë.

* Njeriu ka nevojë të madhe ta lusë shpesh Allahun me këtë lutje, në sexhde gjatë namazit dhe jashtë tij.

LUTJA E NËNTË

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْبُخْلِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنَ الْجُبْنِ، وَأَعُوذُ بِكَ
مِنْ أَنْ أُرَدَّ إِلَى أَرْدَلِ الْعُمَرِ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الدُّنْيَا وَعَذَابِ الْقَبْرِ

All-llahum-me in-ní eûdhu bike minel bukhli, we eûdhu bike
minel xhubni, we eûdhu bike min en urad-de ilé erdhelil ûmuri,
we eûdhu bike min fitnetid-dunjé we âdhébil kabr.

**“O Allah! Kërkoj mbrojtje tek Ti prej koprracisë,
prej paguximit, prej pleqërisë së shtyrë (matufosjes),
prej sprovës së kësaj jete dhe prej dënimit të varrit!”**

Shënon Buhariu.

—...◦◦◦ *Sqarimi* ◦◦◦—

* *Bukhl* - Koprracia në dhënien e asaj që është obligim të jepet/shpenzohet, për familjarët dhe për ata që ke nën kujdes, apo në dhënien ndaj lypësit kur të kërkon duke pasur mundësi ta ndihmosh etj. Ky është një tipar i nënçmuar.

* *Xhubn* - Paguximi, e kundërta e guximit/trimërisë, është kur njeriu ka frikë të veprojë një gjë. Kjo zakonisht rrjedh si rezultat i zemrës së dobët. Edhe ky është një tipar i nënçmuar.

* *Mosha shumë e shtyrë* - kur njeriu bëhet sikurse fëmija, nuk logjikon, kupton pak, ka forcë të dobët etj.

* *Sprova e kësaj jete* - dëshirat e epshet e ndaluara të kësaj bote të cilat preokupojnë dhe largojnë nga adhurimi ndaj Allahut.

* *Dënimi i varrit* - me shpirt dhe me trup, për ata që e meritojnë, në jetën e varrit.

LUTJA E DHJETË

رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا وَإِنْ لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ

Rabbené dhalemné eñfusené we il-lem tegfirlené
we terhamné lenekúnen-ne minel khásirín.

**“O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah,
prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne
vërtet që do të jemi nga të humburit!”**

Araf 23.

—... Sqarimi ...—

* Kjo lutje përfshin pranimin e mëkatit, nënshtrimin e përluljen ndaj Allahut, shfaqjen e nevojës për Atë, kthimin me pendim tek Ai dhe kërkimin e faljes dhe mëshirës prej Tij.

* Nëse Allahu nuk na shlyen gjurmët dhe pasojat e mëkatit dhe nuk na mëshiron, atëherë do të jemi në një humbje të madhe, në të dy botët.

* Njeriu patjetër që do të veprojë gabime e mëkate (e tillë është natyra njerëzore), prandaj është detyrë për të që posa të bie në mëkat të shpejtojë në pendim dhe kërkim falje, në mënyrë që të shpëtojë prej pasojave të rënda të mëkatimit, në këtë botë dhe tjetrën.

* Këtë lutje e ka bërë Ademi (alejhisselam).

LUTJA E NJËMBËDHJETË

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْهَمِّ وَالْحَزَنِ

All-llahum-me in-ní eûdhu bike minel hem-mi wel hazen.

**“O Allah, kërktoj mbrojtje tek ti prej pikëllimit dhe
shqetësimit (ankthit)!”**

Shënon Buhariu.

—...*Sqarimi*...—

* *Hemm dhe hazën janë dhimbje dhe vuajtje shpirtërore.*

* Ibën Kajimi (Allahu e mëshiroftë!) ka shkruar:

“Dhimbjet dhe vuajtjet që e godasin zemrën janë dy lloje:

1. Për shkak të gjërave të kaluara. Kjo është hazën- kur je i trishtuar dhe i pikëlluar për të kaluarat.

2. Për shkak të gjërave të së ardhmes. Kjo është hemm- kur je i shqetësuar dhe në ankth për gjërat që do të vijnë në të ardhmen dhe se çfarë do të të ndodhë (si: dikush ka frikë prej varfërisë, dikush prej sëmundjeve, dikush prej humbjes së të afërmeve etj.).”

LUTJA E DYMBËDHJETË

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ جَهْدِ الْبَلَاءِ، وَدَرَكِ الشَّقَاءِ

All-llahum-me in-ní eûdhu bike min
xhehdil belé'i we derakish-sheká'i.

**“O Allah, kërkoj mbrojtje tek Ti prej belasë (sprovës)
së vështirë dhe prej kaplimit të mjerimit!”**

Buhariu dhe Muslimi.

—... *Sqarimi* ...—

* Belaja e vështirë është çdo gjë që e godet njeriun prej fatkeqësive e sprovave të rënda e të papërballueshme.

* Mjerimi është e kundërta e lumturisë. Ai është vetëshkatërrimi apo janë ato gjëra që çojnë në shkatërrim. Kjo përfshin edhe çështjet e kësaj bote dhe të botës tjetër.

* Ne duhet ta lusim Allahun që të mos na kaplojë mjerimi në çështjet e kësaj bote (siç është dëmtimi, shkatërrimi) dhe të botës tjetër (siç është devijimi, humbja nga rruga e drejtë etj.).

LUTJA E TREMBËDHJETË

رَبِّ أَشْرَحْ لِي صَدْرِي وَيَسِّرْ لِي أَمْرِي
وَأَحْلِلْ عُقْدَةً مِّنْ لِّسَانِي يَفْقَهُوا قَوْلِي

Rabbi shrah lí sadrí, we jes-sir lí emrí, wehlul
ûkdetem-mil-liséní, jefkahú kaulí.

**“O Zoti im, zgjeroma kraharorin tim, lehtësoma
punën time dhe zgjidhma nyjën e gjuhës sime, që ata
të kuptojnë fjalën time!”**

Ta he, 25-28.

—... *Sqarimi* ...—

* Këtë lutje e ka bërë Musa (alejhi ue selem), kur e ka përcjell mesazhin e Allahut te njerëzit.

* **“zgjeroma kraharorin tim”**- është lutur që Allahu t’i japë forcë shpirtërore e morale, që ta dërgojë në vend misionin me të cilin e kishte ngarkuar Allahut.

* Kjo lutje patjetër do të sjellë si rezultat të qenët i duruar në këtë rrugë dhe përkushtimin ndaj thirrjes së njerëzve për tek Allahu me ambicie të lartë. Kraharori i ngushtë ka për rezultat lodhjen e plogështinë, dhe kjo është prej gjërave që shkaktojnë dobësi dhe rënie të vendosmërisë.

* **“lehtësoma punën time”** – Më ndihmo ta dërgoj në vend mesazhin Tënd te njerëzit. Kur Allahu ia lehtëson çështjet

thirrësit, atëherë ia mundëson që:

a. T'i drejtohet secilit me fjalë të përshtatshme për të, aq sa kupton.

b. Të përzgjedh rrugët më të shpejta që të tjerët t'ia pranojnë fjalët.

c. T'ua sqarojë fenë njerëzve në mënyrën më të mirë.

*** “dhe zgjidhma nyjën e gjuhës sime”** – që Faraoni dhe populli i tij t'i kuptojnë fjalët e tij (Musait) dhe të arrihet qëllimi i thirrjes për tek Allahu. Oratoria është prej shkaqeve që ndihmojnë t'ua sqarosh njerëzve fenë.

LUTJA E KATËMBËDHJETË

اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ مُنْكَرَاتِ الْإِخْلَاقِ، وَالْأَعْمَالِ وَالْأَهْوَاءِ

All-llahum-me in-ní eûdhu bike min munkerátíl
e'khlék, wel e'âméli, wel e'hwé'.

**“O Allah, kërkoj mbrojtje tek Ti prej
moraletë të këqija, veprave të këqija dhe prej
dëshirave (tekave) të këqija!”**

Shënon Tirmidhiu.

—... *Sqarimi* ...—

* Moralet e këqija janë shkak që njeriut t'i vijë çdo e keqe dhe t'i largohet çdo e mirë.

* Veprat e këqija – gjynahet që bën.

Disa dijetarë kanë thënë se me moralet e këqija është fjala për veprat e zemrës, ndërsa me veprat e këqija është fjala për veprat e gjymtyrëve.

* Dëshirat, epshet dhe tekat e këqija e të ndaluara e shtyjnë njeriun të bie në çdo të keqe. Prej tyre burojnë mosbindjet ndaj urdhrave të Allahut dhe devijimet.

LUTJA E PESËMBËDHJETË

اَللّٰهُمَّ اِهْدِ قَلْبِي، وَسَدِّدْ لِسَانِي، وَثَبِّتْ حُجَّتِي وَاسْلُلْ سَخِيْمَةَ قَلْبِي

(All-llahum-me) Ehdi kalbí, we sed-did liséni, we
theb-bit huxh-xhetí, weslul sekhímete kalbí.

**“(O Allah) Udhëzoje zemrën time,
përmirësoje gjuhën time, forcoje argumentin
tim dhe largoji veset e liga prej zemrës time!”**

Shënon Ebu Daudi, Tirmidhiu dhe ibën Maxheh.

—... *Sqarimi* ...—

* Udhëzoje zemrën time të të njohë Ty o Allah dhe të njohë të vërtetën dhe rrugën e drejtë.

* Përmirësoje gjuhën time në mënyrë që ajo të flasë gjithmonë vetëm të vërtetën dhe të flasë fjalë të sakta e të duhura.

* Forcoje argumentin tim në jetën e kësaj bote, duke bërë që argumentet e mia të jenë bindëse dhe të qarta: kur polemizoj me kundërshtarët e Tu, kur thërras në rrugën Tënde, kur urdhëroj për të mirë dhe kur ndaloj nga e keqja etj. Gjithashtu, forcoje dëshminë (fjalën) time në botën tjetër kur do të më marrin në pyetje dy engjëjt në varr.

* Largoji veset e liga dhe cilësitë e këqija të cilat mund t'i kem në zemrën time, si: mashtrimi, urrejtja, armiqësia,

zilia, mëria, qëllimi i keq etj. Pastroje zemrën time prej këtyre mëkateve.

* Nëse Allahu nuk i dëlirë zemrat tona prej këtyre gjërave të liga, atëherë ato do të nxënë vend në to.